

## **RREGULLORE E BRENDSHME PËR SISTEMIN E VËZHGIMIT ME KAMERA (CCVT).**

Shkolla Tomorrow`s Education System (TES), përdor sistemin e saj të mbikëqyrjes video (CCTV).

Për vetë llojin e aktivitetit të shkollës e ka të domosdoshme survejimin e ambienteve të saj, me qëllimin kryesor sigurinë e nxënësve, personelit, mbrojtjen e pronës, aseteve, vizitoreve dhe kontrollit të hyrje-daljes në ambientet e saj.

Sistemi i mbikëqyrjes me video ofron siguri dhe ndihmon në parandalimin, pengimin dhe zbulimin e çdo aksesit fizik të paautorizuar, duke përfshirë zonat e vendosura nën mbikëqyrje ose mbrojtje, infrastrukturë IT ose informacion operacional, në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e ngjarjeve të rrezikshme për nxënësit, vjedhjes së pajisjeve ose pronës që i përkasin kompanisë, nxënësve, vizitorëve ose stafit të saj ose veprimeve që kërcënojnë sigurinë në mjediset e shkollës.

Baza ligjore:

- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr.9887, date 10.03.2008.
- Udhëzim nga ministria e brendshme nr.134, date 10.03.2017, për përcaktimin e masave shtesë të sigurisë,
- Udhëzimi nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 46, date 28.3.2017 Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Kamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë;

- Hyrjen e shkollës dhe oborrin përpara në krah dhe pas godinës së shkollës.
- Korridoret e brendshme të shkollës në të gjitha hyrjet e saj dhe në çdo kat.

- Mjediset e klasave dhe të argëtimit në godinë.
- Mjedisin e hyrjes së tualeteve të shkollës.
- Mjediset e mensave.
- Ambientet e laboratorëve, bibliotekës, palestrës, administrates etj.
- Hyrjen e sekretarisë, drejtorisë, serverit dhe magazinës së shkollës.
- Kamerat regjistrojnë vetëm imazhet që kanë lidhje me qëllimin për të cilin sistemi CCTV është miratuar dhe instaluar.
- Në çdo zonë ku janë të instaluara kamera vëzhgimi, është vendosur njoftimi në zonë të dukshme nga të gjithë, sipas aneksit të aprovuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- Në ambientin ku janë vendosur këto pajisje lejohet hyrja dhe përdorimi vetëm nga personi i autorizuar nga administratori i shkollës që është specialist i IT.
- Aksesit i pamjeve të regjistruara është i kufizuar vetëm për personin e autorizuar. Të gjitha akseset ose shikimet e pamjeve të regjistruara ndodhin vetëm brenda nje ambienti të përcaktuar dhe pjesa tjetër e stafit nuk lejohen të hyjnë në atë zonë ose të kenë akses ndaj pamjeve.
- Shkolla vendos në dispozicion pamjet vizive ose të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevojat hetimi, bazuar në Kodin e Procedurave Penale dhe në legjislacionin në fuqi.
- Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit ruhen për një periudhë kohore prej 7 ditësh, dhe pas kalimit të kësaj periudhe, të dhënat fshihen.
- Çdo individ ka të drejtën që të njihet me të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet një kërkesë me shkrim.
- Çdo person apo subjekt, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur
- Për çdo pyetje apo kërkesë rreth kësaj politike mund të kontaktoni në numrin drejtores së shkollës, në adresën e –mailit ose në adresën e shkollës Rr. Bashkim Shkurti, Kashar, Tiranë.

Adminstrator

Flamur Gjymishka